



KORRIK 2026

BULETINI



Konferenca mbi funksionimin e gjyqësorit në veri të Kosovës

Më 16 korrik 2026, OJQ ACDC organizoi në Mitrovicën e Veriut një konferencë kushtuar funksionimit të gjyqësorit, qasjes në drejtësi dhe kthimit të mundshëm të gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit gjyqësor serb në institucionet e drejtësisë në Kosovë.

Avokatë, ekspertë ligjorë, përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare dhe të organizatave të shoqërisë civile diskutuan sfidat e riintegritit dhe masat për forcimin e besimit të qytetarëve në sistemin gjyqësor. Pjesëmarrësit vlerësuan se kthimi i personelit gjyqësor serb mund të përmirësonte qasjen në drejtësi, me kusht që procesi të zhvillohet në mënyrë transparente dhe në përputhje me ligjin.

Ngjarja u organizua në kuadër të projektit “Mbështetje për riintegrimin, të drejtat gjuhësore dhe zvogëlimin e numrit të lëndëve të pazgjidhura”, me mbështetjen e UNMIK-ut.





Konferenca përmbyllëse e projektit “Së bashku për lumenj të pastër”

Konferenca përmbyllëse e projektit “Së bashku për lumenj të pastër” u mbajt më 29 korrik 2026 në Shtëpinë e BE-së në Mitrovicën e Veriut. U prezantua një publikim i bazuar në hulumtime në terren dhe në hartëzimin e më shumë se 200 lokacioneve kritike përgjatë lumit Ibër. Ndër to përfshihen deponitë ilegale të mbeturinave, shkarkimet e drejtpërdrejta të ujërave të zeza, vendet e nxjerrjes së rërës dhe zhavorrit, barrierat ujore dhe burime të tjera të degradimit të mjedisit. 📄

Përfaqësuesit e programit IWRM-K, hulumtuesit dhe ekspertët diskutuan gjetjet, zbatimin e rekomandimeve dhe hapat e ardhshëm drejt mbrojtjes më efikase të lumit Ibër.



Prezantimi i nismave rinore për mbrojtjen e mjedisit

Pesë nisma lokale rinore nga Zveçani, Mitrovica e Veriut dhe e Jugut, Zubin Potoku dhe Leposaviqi u prezantuan më 23 korrik 2026 në Liqenin e Ujmanit. Nismat përfshinë aksione pastrimi, aktivitete edukative, një ekspozitë fotografike, promovimin e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve ujore dhe vendosjen e një sistemi për grumbullimin e ujërave të shiut. Ngjarja përfundoi me një aksion të përbashkët për pastrimin e hapësirës përreth Liqenit të Ujmanit.

Aktivitetet u realizuan në kuadër të projektit “Së bashku për lumenj të pastër”, të cilin REC dhe OJQ ACDC e zbatojnë në kuadër të Programit për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore në Kosovë (IWRM-K). Programi financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe Qeveria e Kosovës, ndërsa zbatohet nga Skat Consulting Ltd. në konsorcium me Agjencinë Austriake të Mjedisit.



Përfundoi me sukses projekti “Farat e bashkëpunimit”

Projekti “Farat e bashkëpunimit: Ndërtimi i hapësirave të gjelbra multietnike në Mitrovicë” përfundoi me sukses në korrik 2026. Të rinjtë nga komunitete të ndryshme rregulluan hapësira të gjelbra, morën pjesë në aksione pastrimi dhe zhvilluan nisma mjedisore. Në ngjarjen përmbyllëse u shfaq një film dokumentar mbi aktivitetet e realizuara, rezultatet e arritura dhe angazhimin e përbashkët të të rinjve.

Ky aktivitet u realizua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Për përmbajtjen e tij është përgjegjës vetëm CARE Deutschland e.V. dhe ajo nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Komunikata për shtyp

Veprimet e institucioneve gjatë shënimit të Vidovdanit



ACDC, NSI, Aktiv, InTER dhe CASA shprehën shqetësimin e tyre për veprimet e Policisë së Kosovës gjatë shënimit të Vidovdanit, raportimet për keqtrajtim dhe konfiskimin e dokumenteve. Institucionet kompetente u ftuan ta hetojnë rastin dhe të sigurojnë mbrojtje të barabartë të të drejtave të të gjithë qytetarëve.

Kërkesë drejtuar Bankës Botërore lidhur me Liqenin e Ujmanit



Pesë organizata të shoqërisë civile nga veriu i Kosovës kërkuar nga Banka Botërore që, përpara ofrimit të çfarëdo mbështetjeje të ardhshme për ndërmarrjen “Ibër-Lepenc”, të kryejë një vlerësim të hollësishëm të rreziqeve mjedisore, sociale dhe institucionale, duke marrë parasysh marrjen dhe rrënimin e fundit të objekteve përreth Liqenit të Ujmanit.

Reagim lidhur me rrënimin e hotelit “Jezero”



Organizatave të shoqërisë civile i bënë thirrje prokurorisë dhe institucioneve të tjera kompetente që të shqyrtojnë ligjshmërinë e rrënit të hotelit “Jezero”, si dhe veprimet e policisë dhe inspektorëve gjatë rrënit të objekteve në Liqenin e Ujmanit dhe në Mitrovicën e Veriut.

ACDC në media

Gjatë muajit korrik, drejtori ekzekutiv i ACDC-së, Dušan Radaković, komentoi çështjet kryesore politike dhe gjyqësore në Kosovë:

- Mbi mundësinë e mbajtjes së zgjedhjeve të reja parlamentare dhe lodhjen në rritje të qytetarëve për shkak të proceseve të shpeshta zgjedhore. 
- Mbi pasojat e pranimi të dorëheqjeve të personelit gjyqësor serb për qasjen në drejtësi dhe funksionimin e gjyqësorit në veri të Kosovës. 
- Mbi pjesëmarrjen e diasporës në jetën politike përmes mekanizmave ekzistues zgjedhorë, në vend të vendeve të veçanta në Kuvend. 
- Mbi mundësitë për riintegrimin e gjyqtarëve serbë dhe kthimin e tyre të mundshëm në institucionet e drejtësisë në muajin shtator. 
- Mbi renditjen e hapave të nevojshëm për krijimin e institucioneve të Kosovës pas konstituimit të Kuvendit. 
- Mbi interesimin e kufizuar të partive politike shqiptare në Kosovë për dialogun dhe të ardhmen e Asociacionit/Bashkësisë së Komunave me Shumicë Serbe. 



Drejtori i programeve i ACDC-së, Aleksandar Rapajić, paraqiti pikëpamjet e tij mbi çështjet aktuale politike dhe gjyqësore në Kosovë:

- Mbi kushtet politike dhe institucionale të nevojshme për kthimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë, presionet politike ndaj këshillave gjyqësorë dhe mungesën e personelit të kualifikuar gjyqësor nga komuniteti serb. 
- Mbi kushtet politike të nevojshme për kthimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë. 
- Mbi mbylljen e rrugës administrative për kthimin e prokurorëve serbë dhe personelit gjyqësor pas vendimeve të institucioneve të Kosovës. 
- Mbi mungesën e një marrëveshjeje politike për zgjedhjen e presidentit dhe vazhdimin e pasigurisë institucionale në Kosovë. 



www.acdc-kosovo.org



office@acdc-kosovo.org



www.facebook.com/Ngoacdc



www.instagram.com/acdc.kosovo



www.x.com/ngo_acdc

